



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.02.2019, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datave 28.01.2019 dhe 29.01.2019.
2. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e Protokollit të Traktatit të Atlantikut Verior për aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Xhemal Qefalia, Luan Duzha, Luan Harusha, Sadi Vorpsi, Anduel Xhindi, Myslim Murrizi, Ervin Salianji, Endrit Braimllari, Flamur Noka , Elona Hoxha, Xhemal Gjunksi, Antoneta Dhima, Pjerin Ndreu dhe Paulin Sterkaj.

Mungojnë:

Isuf Çela, Elena Xhina, Luan Rama dhe Andon Frrokaj

Të ftuar:

Artemis Dralo – Zëvendësministre për Europën dhe Punët e Jashtme

Armand Skapi - Drejtor i Traktateve në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

Ilir Melo - Drejtor i Drejtorisë së Rajonit dhe Vendeve Fqinje në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

Kol Petrit Çuni - Drejtor i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së

Gjergj Methoxha - Drejtor i Drejtorisë së Politikave të NATO dhe BE në Ministrinë e Mbrojtjes

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëdita kolegë!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Sigurinë Kombëtare.

Sot në rendin e ditës së këtij komisioni kemi miratimin e procesverbaleve të datave 28 dhe 29 janar të vitit 2019. Besoj se nga kolegët nuk ka ndonjë vërejtje.

Si pikë të dytë të rendit të ditës kemi shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e Protokollit të Traktatit të Atlantikut Verior për aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, dhe bëhet fjalë për aderimin në NATO.

Si fillim, dua t’i bëj me dije kolegëve se në seancën e kaluar plenare është marrë vendimi për kalimin me procedurë të përshpejtuar të këtij projektligji dhe miratimi i vendimeve, në fakt, ka qenë unanim, në kuptimin që të gjitha grupet parlamentare të Kuvendit të Shqipërisë janë dakord që të ratifikohet menjëherë ky protokoll dhe Republika e Maqedonisë së Veriut të mund të bëhet anëtare me të drejta të plota, në NATO.

Ditën e enjte, kur ne do të zhvillojmë seancën plenare, Kuvendin e Shqipërisë do ta përshëndesë personalisht edhe Kryetari i Kuvendit të Maqedonisë së Veriut, zoti Telat Xhaferri. Kështu, pa humbur kohë, unë do të prezantoj të ftuarin nga Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, zotin Armand Skrapi, që është drejtori i traktateve ,më herët ai ka qenë pjesëmarrës në këtë komision, për të na thënë dy fjalë lidhur me këtë projektligj dhe protokollin në vetvete.

Fjala është për ju, zoti Skapi.

Armand Skapi – Faleminderit!

Së pari, ju kërkoj ndjesë, pasi pjesa tjetër e përfaqësuesve të Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme dhe Ministrisë së Mbrojtjes janë në Komisionin e Ligjeve, duke mbrojtur projektligjin në fjalë!

E nderuar zonja kryetare,

Të nderuar deputetë,

Projektligji synon ratifikimin e Protokollit të Traktatit të Atlantikut të Veriut për aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nënshkruar më 06.02.2019 në Bruksel.

Paraqitja në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë së këtij protokollit për ratifikim vjen në zbatim të nenit 17 të ligjit nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e

Shqipërisë”. Traktati i Atlantikut të Veriut parashikon, në mënyrë të qartë, se vendimi për anëtarësimin e shteteve të reja merret me unanimitet nga ana e shteteve anëtare.

Ftesa që iu akordua nga NATO Republikës së Maqedonisë erdhi si një vlerësim i vullnetit të vazhdueshëm politik të vendit tonë fqinj për t’u anëtarësuar në NATO, për reformat e ndërmarra nga ky vend, për përballimin e sfidave të sigurisë, si dhe angazhimi për të përfunduar marrëveshjen historike lidhur me emrin e tij si shtet. Këtu dua të nënvizojmë edhe rolin konstruktiv dhe mbështetës që faktori shqiptar në Maqedoninë e Veriut i ka dhënë procesit të anëtarësimit të këtij vendi në NATO.

Rotacioni politik në vendin fqinj dhe kryesisht arritja e Marrëveshjes së Prespës për çështjen e emrit me Greqinë i nxitën vendet anëtare të NATO-s që në takimin e krerëve të shteteve dhe qeverive të vendeve anëtare të Aleancës, të mbajtur më 11-12 korrik 2018, që t’i akordojnë Republikës së Maqedonisë së Veriut ftesën për t’u anëtarësuar në NATO.

Ratifikimin e protokollit të anëtarësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në NATO, në aspektin politik, është në zbatim të plotë të politikës së NATO-s të “Dyerve të hapura” dhe, gjithashtu, përbën një shembull të qartë të parimit politik demokratik, se çdo shtet sovran ka të drejtën e pakundërshtueshme për të zgjedhur në mënyrë të lirë aleancat e tij.

Republika e Maqedonisë së Veriut ka bërë një rrugë relativisht të gjatë drejt anëtarësimit në NATO. Kështu, përpjekjet institucionale të Republikës së Maqedonisë së Veriut për të arritur anëtarësimin në NATO filluan me anëtarësimin në nismën e partneritetit për paqe më 15 nëntor 1995.

Në atë kohë, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë u pranua gjithashtu në Këshillin e Bashkëpunimit të Atlantikut të Veriut, i pasuar në vitin 1997 nga Këshilli i Partneritetit Euroatlantik. Më 14 qershor 1996 në Shkup u hap zyra për ndërlidhje e NATO-s dhe në fund të vitit 1997 u hap në Selinë e NATO-s misioni i përhershëm i ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë.

Në prill të vitit 1999, në Samitin e NATO-s në Uashington, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë iu dha statusi i vendit kandidat për anëtarësim dhe që prej asaj kohe filloi pjesëmarrja e vendit në planin e veprimit për anëtarësim.

Republika e Maqedonisë së Veriut ka kryer deri tani më shumë cikle të këtij plani se çdo anëtar i ri i NATO-s që prej vitit 2009 dhe është vlerësuar pozitivisht nga vendet aleate për pjesëmarrjen e saj në misionet ndërkombëtare të paqeruajtjes, duke filluar që prej vitit 2002 me

misionin e ISAF në Afganistan, si dhe në vitin 2006 në misionin e BE-së “ALTHEA”, në Bosnjë dhe Hercegovinë.

Në rrafshin e sigurisë, ky anëtarësim ndikon drejtpërsëdrejti në rritjen e sigurisë në hapësirën euroatlantike dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Anëtarësimi i Republikës së Maqedonisë së Veriut në NATO redukton më tej influencën e fuqive të treta në rajonin tonë dhe ndikon ndjeshëm në forcimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë. Siç e kanë bërë të qarta vendet anëtare të NATO-s, procesi i reformave në Republikën e Maqedonisë së Veriut duhet të vazhdojë jo vetëm gjatë periudhës së anëtarësimit, por edhe më pas. Ky është një proces në vazhdimësi, që synon bërjen shtet anëtar i NATO-s me të drejta të plota. Vendet aleate kanë bërë gjithashtu të ditur se dëshirojnë të shohin përparim në lëmin e reformave në sektorin e inteligjencës dhe sigurisë, sundimit të shtetit ligjor, pavarësisë së gjyqësorit dhe aftësive mbrojtëse të vendit.

Me hyrjen në fuqi të këtij protokolli nga të gjitha vendet anëtare, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s i komunikon qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut ftesën për t’u pranuar në Traktatin e Atlantikut të Veriut. Në përputhje me nenin 10 të Traktatit, Republika e Maqedonisë së Veriut do të bëhet palë në të kur të depozitojë instrumentin e anëtarësimit në qeverinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që është depozituese e Traktatit. Protokolli do të hyjë në fuqi kur secila nga palët e Traktatit të Atlantikut të Veriut të ketë njoftuar për vendimin e marrë qeverinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Për Republikën e Shqipërisë kjo procedurë do të ndiqet pas hyrjes në fuqi të ligjit të ratifikimit të këtij protokolli.

Të nderuar deputetë, nëpërmjet këtij ratifikimi Republika e Shqipërisë bëhet një ndër vendet e para të Aleancës, që shprehet pozitivisht për anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në NATO.

Faleminderit!

Ermonela Felaj- Faleminderit, zoti Skapi!

Sikurse e thatë edhe ju në fjalën tuaj, kuptohet se ky është një moment i rëndësishëm për Republikën e Maqedonisë së Veriut, por edhe për Shqipërinë, si pjesë e vendeve të Ballkanit, që duke qenë vende të lira demokratike, zgjedhin edhe Aleancën në të cilën do të bëjnë pjesë. Në respekt të këtij momenti të veçantë, duke qenë se Komisioni i Sigurisë është komision përgjegjës për këtë projektligj, unë ia kaloj fjalën relatorit, zotit Vorpsi.

Sadi Vorpsi – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar kolegë deputetë, do të përpiqem ta përmbledh diskutimin për këtë projektligj, i cili synon ratifikimin e protokollit të traktatit të Atlantikut të Veriut për aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nënshkruar me datë 06.02.2019 në Bruksel, i cili në aspektin politik është në zbatim të plotë të politikës së NATO-s dhe përbën një shembull të qartë të parimit politik demokratik, se çdo shtet sovran ka të drejtën e pakundërshtueshme për të zgjedhur në mënyrë të lirë aleancat e veta.

Traktati i Atlantikut të Veriut si dokument kryesor themelues i NATO-s, në nenin 10 parashikon mënyrën e anëtarësimit të vendeve të reja në këtë aleancë. Ky nen parashikon në mënyrë të qartë se vendimi për anëtarësimin e shteteve të reja merret në unanimitet nga vendet anëtare. Vendet anëtare të NATO-s, në takimet e krerëve të shteteve dhe të qeverive të vendeve anëtare të aleancës të mbajtur me 11 dhe 12 korrik, vendosën që t'i akordojnë Republikës së Maqedonisë së Veriut ftesën për t'u anëtarësuar në NATO. Kjo ftesë erdhi në vlerësim të vullnetit të vazhdueshëm politik të Republikës së Maqedonisë së Veriut për t'u anëtarësuar në NATO, falë reformave të ndërmarra nga ky vend në rrugën drejt anëtarësimit dhe angazhimit për përballimin e sfidave të sigurisë, si dhe angazhimit për të përfunduar marrëveshjen historike, lidhur me emrin ndërmjet Athinës dhe Shkupit.

Nënshkrimi i këtij protokolli në datën 06.02.2019 nga parlamenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe nga 29 vendet e NATO-s, gjithashtu edhe ratifikimi nga parlamentet e tyre e parlamenti ynë, do të mundësojë pranimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në traktatin e Atlantikut të Veriut, duke e bërë Maqedoninë vend anëtar të NATO-s. Ky anëtarësim do të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e sigurisë euroatlantike në rajonin e Ballkanit Perëndimor, ku do të reduktojë influencën e fuqive të treta në rajonin tonë dhe do të ndikojë ndjeshëm në forcimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë.

Të nderuar kolegë, ju ftoj ta miratojmë këtë projektligj.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Vorpsi!

Komisionit i janë bashkuar zëvendësministria e Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, zonja Artemis Dralo dhe zoti Ilir Melo, drejtor i Drejtorisë së Rajonit dhe Vendeve Fqinj.

Faleminderit!

Përpara se t'ua kaloj fjalën kolegëve të këtij komisioni, dua të ftoj të gjithë anëtarët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Kush është dakord për miratimin në parim të projektligjit “Për ratifikimin e protokollit të Traktatit të Atlantikut Verior, për aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut”?

Të gjithë kolegët janë pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Fjala është për zotin Gjunksi.

Xhemal Gjunksi – Përshëndetje, zonja kryetare!

Të nderuar pjesëmarrës, marrëveshja e arritur për zgjidhjen e emrit mes Maqedonisë dhe Greqisë, për partneritet strategjik zhbllokoi procesin e integritetit euroatlantik. Këshilli i Atlantikut të Veriut, javën e kaluar, miratoi me vendim unanim ftesën për anëtarësimin e plotë të Maqedonisë në NATO.

Pak ditë më vonë Këshilli i Ministrave për Marrëdhëniet me Jashtë të shteteve anëtare të Bashkimit Europian, ka vendosur 19 qershori të jetë data që do të hapen negociatat për anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë në BE. Pra shikojmë që detyrat e shtëpisë nga ana e Maqedonisë së Veriut janë bërë shumë mirë.

Së pari, ata punuan dhe guxuan në zgjidhjen e emrit me Greqinë.

Së dyti, ishte Marrëveshja për Mirëqenie dhe Fqinjësi të Mirë me Bullgarinë dhe së treti, ligji “Për avancimin e gjuhëve të huaja”. Sigurisht që këto janë garanci më të forta për Republikën e Maqedonisë së Veriut, e cila do të ballafaqohet në periudhat e ardhshme dhe në vazhdim.

Republika e Shqipërisë në raport me Republikën e Maqedonisë, për detyrat tona të shtëpisë shikohet që jemi akoma larg. Detyrat tona vijnë gjithnjë duke u vështirësuar, sepse për hapjen e negociatave kërkohet të përmbushen një sërë detyrash, por kjo sipas të gjitha raporteve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës të Anglisë dhe Gjermanisë kërkohet dhe theksohet që Shqipëria në radhë të parë të çmontojë strukturat kriminale.

NATO tani merret me forma të reja të kërcënimeve të sigurisë, si luftërat kibernetike, hibride dhe ato propagandistike, duke përfshirë këtu lajmet e rreme apo *fake news*, ku të gjitha këto janë prioritetet aktuale të sigurisë.

Institucionet e sigurisë dhe shërbimet e inteligjencës do të shkëmbejnë informacione, të cilat janë të dobishme në aspektin e sigurisë me vendet anëtare, si dhe do të parandalojnë kërcënime të caktuara të sigurisë.

Anëtarësimi i Maqedonisë në NATO është një kontribut në stabilitetin rajonal. Këto arritje do të kenë ndikim në stabilitetin dhe perspektivën e të gjithë rajonit. Pas anëtarësimit të

plotë në NATO, Republikës së Maqedonisë së Veriut i dalin një sërë detyrash, sepse fillon procesi i integritetit të Maqedonisë në NATO, e cila kërkon një periudhë prej 5 deri në 7 vjet. Në bazë të informacioneve që kemi për detyrat që ata kanë realizuar, do të thotë që këtë kohë ata do ta përshpejtojnë. Këtu do të jetë i nevojshëm edhe kontributi që do të japin edhe Forcat tona të Armatosura dhe të gjithë ne që jemi këtu për ta përshpejtuar këtë proces që Maqedonia pas anëtarësimit të plotë të integrohet në NATO.

Unë i uroj suksese dhe faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Gjunkshi!

Fjala është për zotin Salianji.

Ervin Salianji – Nuk dua të zgjatem, por është një ditë e rëndësishme jo vetëm për aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, për ratifikimin e protokollit, por edhe për bashkimin e pjesës tjetër të shqiptarëve që jetojnë në këtë Republikë në një aleancë të përbashkët me Republikën e Shqipërisë. Për këtë arsye, për ne është dyfish privilegj apo nder i veçantë që jemi pjesë e kësaj legjislature ku kalon ratifikimi i këtij protokollit dhe ku shqiptarët e Maqedonisë kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm si katalizator për t'u pranuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut ndryshimi i emrit, por edhe në rotacionin politik në Maqedoni. Prandaj besoj se për të gjithë ne është e rëndësishme ta votojmë

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Salianji!

Fjala është për zotin Brahimllari.

Endrit Braimllari – Kërkova fjalën për të përshëndetur këtë ratifikim, sepse është një lajm i mirë.

Në emër të Lëvizjes Socialiste për Integritet është nder dhe kënaqësi që sot në Komisionin e Sigurisë votojmë pro ratifikimit të protokollit të Traktatit të Atlantikut Verior për aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, e cila forcon stabilitetin dhe sigurinë në rajon, por vlerësojmë edhe rolin e rëndësishëm që shqiptarët e Maqedonisë së Veriut kanë luajtur si faktor shtetformues.

Ratifikimi i këtij traktati forcon me tej vlerat e NATO-s, sepse i shtohet edhe një vend tjetër i rëndësishëm dhe rajoni ka një arsye më shumë për të forcuar stabilitetin dhe sigurinë.

Është kënaqësi të votojmë pro në këtë drejtim, sepse thelbi kryesor i gjithë kësaj çështjeje është dhënia fund dhe mbyllja e një kalvari të gjatë ndërmjet shteteve fqinje në rajon, por mbi të gjitha krijon siguri në rajon.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Brahimllari!

Më lejoni të falënderoj të gjithë kolegët për prezencën dhe angazhimin! Unë besoj se kjo nuk është vetëm shenjë e angazhimit për një fqinjësi më të mirë me Maqedoninë e Veriut dhe me të gjitha vendet fqinje me Shqipërinë, por i jep mundësinë Kuvendit të Shqipërisë që të jetë një ndër vendet e para që miraton një projektligj të tillë.

Kalojmë në miratimin nen për nen të këtij projektligji.

Kush është dakord me nenin 1 të projektligjit? Kundër? Nuk ka Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Ky ligj parashikohet të hyjë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Kush është dakord me nenin 2 të projektligjit? Kundër? Nuk ka Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit “Për ratifikimin e protokollit të Traktatit të Atlantikut Verior, për aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut”?

Kush është dakord me këtë projektligj? Kundër? Nuk ka Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Këtu mbyllet mbledhja e sotme. Mbledhja e radhës është nesër në orën 10:00.
Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA